



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DREJTORIA MONOTORIMIT, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE
ANALIZËS SË TË ARDHURAVE
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

Nr. 18690 Prot.

Tiranë më, 30/8 /2017

Lënda: Vendimet penale të formës prerë

TË GJITHË DEGË DOGANORE
DREJTORISË SË HETIMIT
DREJTORISË SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Në pikën 4 të kreut **III** të Udhëzimit nr. 14, dt 03.05.2017 “ Për zbatimin e Ligjit nr. 33/2017 “ Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore “ thuhet:

4. Njoftimi zyrtar i tatimpaguesve të cilët përjashtohen nga zbatimi i ligjit, do të bëhet në faqen zyrtare të organit tatimor qendror vendor doganor brënda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi. Ky njoftim përditësohet çdo muaj sipas vendimeve të formës së prerë për veprat penale në fushën tatimore dhe ose doganore të marra pas këtij afati.

Sektori i Monitorimit të Borxhit në mbështetje të nenit 4 të Ligjit nr. 33/2017 “ Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore “ dhe Udhëzimin nr. 14, dt 03.05.2017 “ Për zbatimin e ligjit nr. 33/2017 ”, si dhe bazuar në informacionet e dërguara nga Degët Doganore ka hartuar listën e debitorëve të dënuar me vendim penal të formës prerë në fushën doganore.

Bashkëngjitur lista me 24 subjekte me vendim penal të formës prerë në fushën doganore.

ZV/ DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE

Arben Seferi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR I DREJTORISË PRONËSISË INTELEKTUALE

Pandeli Duro

